

Në bazë të nenit 13 paragrafi (1) të Ligjit për Qendrën Shtetërore të Provimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 142/08, 148/09, 41/14, 55/16, 142/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 59/25) dhe nenit 5 paragrafi 1 të Rregullores për mënyrën, procedurën dhe kriteret për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve, nr. 01-440/3 nga 28.12.2022, nr. 01-176/3 nga 1.3.2023, nr. 01-197/3 nga 15.04.2024, nr. 01-109/3 nga 11.02.2025, nr. 01-157/4 nga 25.3.2025 dhe nr. 01-121/3 nga 9.2.2026, Qendra Shtetërore e Provimeve shpall

KONKURS PUBLIK

për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm – vlerësues të pjesëve të testeve të studimit ndërkombëtar TIMSS 2027 – TIMSS 2027 (Trends in International Mathematics and Science Study)

I. Qendra Shtetërore e Provimeve Shkup shpall konkurs publik për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm – vlerësues për vlerësimin të pjesëve të testeve të studimi ndërkombëtar TIMSS 2027 – TIMSS 2027 (Trends in International Mathematics and Science Study), e cila mat njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësve në matematikë dhe në grupin natyror, dhe atë

- 1) katër vlerësues për gjuhën maqedonase dhe gjuhën angleze dhe
- 2) dy vlerësues për gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze.

II. Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Kandidatët për bashkëpunëtorë të jashtëm – vlerësues të pjesëve të testeve:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të kenë përfunduar të paktën studime akademike të ciklit të parë në fushën përkatëse (sipas normativit për llojin dhe shkallën e përgatitjes profesionale për mësimdhënës të grupit klasor në klasën e katërt dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për arsimin fillor dhe Ligjit për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat fillore dhe të mesme);
- të kenë të paktën 3 (tre) vite përvojë pune në mësimdhënie.

III. Kandidatët detyrimisht e dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- fletëparaqitje të plotësuar (formulari i aplikimit është i vendosur në faqen e internetit: www.dic.edu.mk);
- certifikatë shtetësie;
- kopje të certifikatës/diplomës për përfundimin e studimeve përkatëse akademike të ciklit të parë, të vërtetuar në noter dhe
- vërtetim për marrëdhënie të rregullt pune dhe përvojë përkatëse prej së paku 3 (tre) vitesh në mësimdhënie.

IV. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm – vlerësues të pjesëve të testeve të studimit ndërkombëtar TIMSS 2027 – TIMSS 2027 (Trends in International Mathematics and Science Study), kryhet në mënyrë dhe në procedurë të përcaktuar me Ligjin për Qendrën Shtetërore të Provimeve dhe me Rregulloren për mënyrën, procedurën dhe kriteret për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

V. Afati i paraqitjes nga kandidatët e interesuar është pesë ditë.

VI. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm do të realizohet më së voni në afat prej 18 (tetëmbëdhjetë) ditësh pas përfundimit të afatit të paraqitjes.

VII. Dokumentacioni i vonuar, i paplotë dhe i pavlefshëm, nuk do të jetë lëndë shqyrtimi.

VIII. Fletëparaqitja e plotësuar së bashku me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet në Arkivin e Qendrës Shtetërore të Provimeve (nga ora 10:00 deri në 14:00) ose dërgohet me postë të rekomanduar në adresën e mëposhtme: Qendra Shtetërore e Provimeve – Shkup, rr. “Vasil Gjorgov” p.n., 1000 Shkup, me shënimin: **“Për konkurs publik për bashkëpunëtorë të jashtëm – vlerësues për vlerësimin të pjesëve të testeve të studimi ndërkombëtar TIMSS 2027”**.

IX. Informacione shtesë për konkursin publik mund të merren në numrin e telefonit 076/284-335, çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në 14:00.

QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE